# DËSHMI ARKIVI

**A-426153**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dokumentari “Kur Durrësi bëhej Film” u shfaq në Sheshin Iliria, Durrës |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/dokumentari-kur-durresi-behej-film-u-shfaq-ne-sheshin-iliria-durres-i584415` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 07:09:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 09:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `393775122d629af2fe8c92d0e3d432496ad2a85a15aa526c1a0aa0051ee78e17` |
| TEKSTI | `91c3ad2dbca0a86a998d24c3679a84fac98ca1fda668cb0a609af40ee0ec03a5` |
| PAMJA | `00157c5dfc0eb2ccf475b946d037eb56f8d603ba6583491fa8fe8f647ab80048` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2d19257652dfbcf2f436daf8eab88296edebbdb1ba78b16b0085d25fcdfff8f4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `cae791e3aa00c35889555c700c23f70e42f4133ad0851613176cd0c76c652be7` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 47086362 |
| TRANSAKSIONI | `0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2` |
| IPFS | `QmaTJq3d3L2Lnk9ysZtPZfH9yq1NEa5sUsFa8GtiZPGAjo` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2d19257652dfbcf2f436daf8eab88296edebbdb1ba78b16b0085d25fcdfff8f4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Dokumentari “Kur Durrësi bëhej Film” u shfaq në Sheshin Iliria, Durrës

7 Shtator 2026, 11:05Kulturë TEMA

Dokumentari “Kur Durrësi bëhej Film” u shfaq në

Kinemaja shqiptare u rikthye në vëmendje në Durrës përmes një mbrëmjeje kushtuar filmit, muzikës dhe kujtesës së qytetit, ku u bënë bashkë artistë, kineastë, familjarë të aktorëve durrsakë që nuk jetojnë më dhe dashamirës të kinematografisë.

Dokumentari “Kur Durrësi bëhej Film” u shfaq për të pranishmit në Sheshin Iliria, Durrës.

Në prani të Zëvendësministres së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Lira Pipa, Drejtorit të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, Eljan Tanini, aktorëve, regjisorëve, skenaristëve dhe personaliteteve të artit e kulturës, aktiviteti solli në vëmendje lidhjen e veçantë që Durrësi ka pasur ndër vite me kinematografinë shqiptare.

Mbrëmja u shoqërua nga muzika e paharrueshme e filmave të kompozitorit Haig Zacharian, nën moderimin e aktores Ema Andrea dhe drejtimin artistik të pianistes Ardita Bufaj, me interpretimin e instrumentistëve Xhovana Marku, Igert Zeqiri, Stela Bello dhe Matilda Bajrami.

Një moment i veçantë ishte prezantimi i dokumentarit “Kur Durrësi bëhej Film”, me ide dhe skenar të Brunilda Liçaj dhe produksion të Blerina Shtylla Doracaj, i cili risolli filma, artistë, histori dhe kujtime që kanë lënë gjurmë në Durrës dhe në historinë e kinematografisë shqiptare.

Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja në një postim në rrjetet sociale tha se “kjo mbrëmje na kujtoi se filmi nuk ruan vetëm imazhe: ai ruan qytetet, njerëzit dhe historitë e tyre”.

“Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit mbështesin nismat që sjellin në vëmendje trashëgiminë tonë filmike, e bëjnë atë të afërt për publikun dhe krijojnë ura mes kujtesës kulturore e brezave të rinj”, tha Gonxhja. A.K./TemA

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rama: 27 mijë vizitorë janë ngjitur në Kalanë Rozafa gjatë Gushtit

09:03 Kulturë

Në 10-vjetorin e shenjtërimit të Nënë Terezës, në katedralen e Shën Palit në Tiranë është përuruar shtatorja e Nënë Terezës

20:34 Kulturë / 2 komente

Mjeshtri Esat Musliu nderohet në Festivalin Kombëtar të Filmit Shqiptar

17:13 Kulturë

VIDEO/ Kinemaja shqiptare ka gjetur rrugën për në Evropë. Po për te publiku i saj?

17:00 Kulturë

Presidenti Bajram Begaj mori pjesë në 245-vjetorin e themelimit të Teqesë së Frashërit

15:10 Kulturë / 6 komente

TIFF hapet me filmin "Mother"

13:09 Kulturë

“Festa e Këngës Shqiptare ” për të shtatin vit, Gjergj Leka bashkon brezat përmes muzikës

11:08 Kulturë

Festivali Kombëtar i Filmit shqiptar bashkon kineastët dhe publikun

09:07 Kulturë

Shenjtërimi i Nënë Terezës - Begaj: Nënë Tereza ishte misionarja shqiptare e bamirësisë

21:15 Kulturë / 6 komente

Sot shenjtërimi i Nënë Terezës/ BE dhe SHBA: Trashëgimia e Nënë Terezës duhet të shërbejë si frymëzim për të gjithë

20:05 Kulturë / 4 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikë...**

12:25 Politika / 105 komente

**Pronat para viteve ’91/ Kadastra hap aplikimin online, pë...**

14:25 Sociale / 9 komente

**VIDEO/ ‘O doktori i Enver Hoxhës’- Berisha pritet me prot...**

18:15 Politika / 32 komente

**“Pushteti është një kafshë e përbindshme” - Rama për Ilir...**

15:25 Politika / 58 komente

**Rama përballë 300 pyetjeve, nga Sazani te SPAK dhe pasard...**

08:45 Politika / 50 komente

## Blog Tema

**Pagat e magjistratëve/ Ish deputeti i PD: KLGJ e KLP dolën nga binarët! Opozita gabon, jo për çdo gjë që bën qeveria duhet të dalë kundër**

08:10 Blog

**Pritja e qytetarëve nga titullarët, formalitet apo detyrim?**

19:35 Blog / 2 komente

**Vetëm 8% probabiliteti në Polymarket për rënien e qeverisë Rama këtë vit…**

11:03 Blog

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.